

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	018
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	2
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	2123
Data: Datum: Date:	24, 06, 2015
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, 24 qershor 2015

Ref. 245/018

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 92 dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (*Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010*), nenin 8 (1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (*Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011*) dhe neneve 11 dhe 115 (115.3) të Ligjit 02/L-28 për Procedurën Administrative (*Gazeta zyrtare nr. 8, 1 janar 2007*), nxjerr këtë:

V E N D I M

1. PEZULLOHET zbatimi i paragrafit 10 të nenit 23 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013 mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (dt. 16 janar 2013), deri në ndryshimin e aktit administrativ sipas procedurave ligjore.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i MASHT të njoftoj Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe të gjithë Bartësit Privat të Arsimit të Lartë për pezullimin e zbatimit të paragrafit 10 të nenit 23 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013 mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (dt. 16 janar 2013).
3. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke pas parasysh se neni 23, paragrafi 10 i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013, që obligon institucionet private të akredituara t'i paguajnë Agjencisë së Kosovës për

Akreditim një shumë fikse prej pesë (5) euro për studentë në vit si tarifë tatimore për akreditim, është në kundërshtim me nenin 2, paragrafi 1.2 dhe 1.3 dhe nenin 5, paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (*Gazeta Zyrtare nr. 14, 9 shtator 2011*) dhe duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara dhe me kërkesën nr. prot. 1666 (dt. 18 maj 2015) nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovës dhe kërkesën nr. prot. 2007 (dt. 17 qershor 2015) nga BPrAL "Kolegji AAB", u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Arsim BAJRAMI

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Vendimi ju dërgohet:

- Agjencisë së Kosovës për Akreditim;
- Të gjithë Bartësve Privat të Arsimit të Lartë;
- Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë;
- BPrAL "Kolegji AAB";
- Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
- Departamentit të Arsimit të Lartë MASHT;
- Departamentit Ligjor, MASHT;
- Arkivit të MASHT.